

NDRYSHIME TË SKK 11 “TATIMI MBI FITIMIN” -

I PËRMIRËSUAR

Paragrafët 1, 2, 4 dhe 42 janë ndryshuar. Teksti i shtuar është i nënvizuar, teksti i fshirë ka vizë në mes.

OBJEKTIVI DHE BAZAT E PËRGATITJES

1. Objektivi i Standardit Kombëtar të Kontabilitetit 11 *Tatimi mbi fitimin* (SKK 11 i përmirësuar), miratuar nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit dhe shpallur nga Ministri i Financave, është dhënia e parimeve të njohjes, matjes dhe vlerësimit të mëpasshëm të tatimit mbi fitimin si dhe të shpjegimeve të nevojshme në pasqyrat financiare, të përgatitura në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit. Standardet Kombëtare të Kontabilitetit bazohen në parimet e kontabilitetit dhe të raportimeve financiare të pranuar në shkallë ndërkombëtare, kërkesat e përgjithshme të të cilave përshkruhen në Ligjin nr. 25, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” publikuar në maj 2018.

2. SKK 11 mbështetet në standardin ndërkombëtar të kontabilitetit SNK 12, “*Tatimi mbi të ardhurat*”. SKK 11 i përmirësuar është ndryshuar për t’u bërë i krahasueshëm me Seksionin 29 *Tatimi mbi të ardhurat* të Standardit Ndërkombëtar të Raportimit Financiar për NVM-të (2009). Një tabelë korresponduese e paragrafëve të Standardit me paragrafë të SNRF për NVM (2009) është dhënë në paragrafin 43. Për rastet që nuk janë trajtuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga SKK 11 i përmirësuar ose ndonjë SKK tjetër, drejtuesit e njësisë ekonomike duhet që me miratimin e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit të aplikojnë politika të tilla që sigurojnë një pasqyrim të vërtetë e të besueshëm të pozicionit financiar, performancës financiare dhe ndryshimeve të fluksit të parasë së njësisë ekonomike, siç kërkohet në nenin 11 të Ligjit nr. 25 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, publikuar në maj 2018.

FUSHA E ZBATIMIT

4. Ky Standard mbulon kontabilizimin e tatimit mbi fitimin. Ai i kërkon një njësie ekonomike të njohë pasojat tatimore aktuale dhe të ardhshme nga transaksionet dhe ngjarjet e tjera të njohura në pasqyrat financiare. Njësitë ekonomike të vogla inkurajohen por nuk janë të detyruara të zbatojnë kërkesat e këtij standardi për **tatimin e shtyrë**.

DATA E HYRJES NË ZBATIM

42. Ky standard do të zbatohet në pasqyrat financiare që mbulojnë periudha kontabël, që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2015. Ky standard do të zbatohet në mënyrë prospektive. Ndryshimet kanë datë efektive 1 janar 2020 dhe zbatohen në mënyrë prospektive.